



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-105
Prishtinë, më 1 qershor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 1 QERSHOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati
Nga NDI-ji: Shefik Kastrati dhe
Nga OSBE, Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d t e ditës

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 maj 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 maj 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 maj 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare në pjesën e parë të muajit qershor, dhe ato: më 4 qershor dhe më 10 qershor 2010.

Për mbledhjen plenare, më 4 qershor 2010, u caktua ky

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Ratifikimi i marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hetim parlamentar,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,
10. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë,
9. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

- 3.1 Shqyrtimi i Raportit të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ta shqyrtojnë Raportin e punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime

- 3.2 Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojnë Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- 3.3 Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimet e cekura më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojnë Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009, dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportet me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit këshillëdhënës për mbrojtjen e mjedisit

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit këshillëdhënës për mbrojtjen e mjedisit, dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

3.5 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për lejimin e stafit shtesë për themelimin e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore për pesë (5) pozita të reja

Kryesia, lidhur me Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për lejimin e stafit shtesë për themelimin e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, për pesë (5) pozita të reja, dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.6 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Kryesia, lidhur me Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Kuvendit t’i paraqesë Raportin me rekomandime.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për Integritet për emërimet shtesë të anëtarëve të këtij grupi në komisionet parlamentare dhe për kryetar të Komisionit

Kryesia, lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Përfaqësimi, kryesimi dhe numri i anëtarëve të komisioneve parlamentare është vendosur në mbledhjen plenare të Kuvendit, të mbajtur më 2 nëntor 2009, ndërsa më 25 shkurt 2010, me propozim të Grupit Parlamentar të SLS-së dhe Grupit Parlamentar për Integrim është bërë rindarja e përfaqësimit të këtyre grupeve.
2. Të gjithë deputetët e Grupi Parlamentar për Integrim janë të përfaqësuar me nga një anëtar në komisionet parlamentare.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Danush Ademi (PDAK), për përfaqësim me rotacion, në Kryesinë e Kuvendit.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Përfaqësimi, me rotacion, i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e PDAK-së, në Kryesinë e Kuvendit, është i kushtëzuar me arritjen e marrëveshjes ndërmjet deputetëve të komunitetit që përfaqësojnë PDAK-në.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për dërgimin e raporteve nga ana e komisioneve tjera parlamentare, në përmbushjen e sfidave lidhur me planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohen të gjitha komisionet parlamentare t'ia dërgojnë Komisionit për Integritet Evropian, raportet për veprimet e ndërmarra në përmbushjen e detyrimeve lidhur me Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës, për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009.
2. Raportet duhet të dërgohen në afatin sa më të shkurtër.

3.10 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian për realizimin e mëditjeve shtesë, me rastin e vizitës zyrtare në Bullgari

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. U lejohet qëndrimi edhe për një ditë, si dhe mëditjet shtesë anëtarëve të Komisionit për Integrime Evropiane: Zylfije Hundozi, Fatmir Rexhepi dhe Njomza Emini, në Bullgari, më 30.4.2010.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

- 3.11 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, për vizitë zyrtare në Estoni

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. U lejohet vizita zyrtare në Parlamentin e Estonisë, prej 6- 10 qershor 2010, anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në këtë përbërje: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj dhe Suzan Novoberdaliu, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Antigona Ibraj dhe e një përkthyesi nga Administrata e Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit i mbulon nikoqiri, ndërsa udhëtimi dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094.

- 3.12 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për vizitë zyrtare në Bruksel.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. U lejohet vizita zyrtare në Bruksel, prej 14 - 18 qershor 2010, anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në këtë përbërje: Naser Rugova, Naim Maloku, Zylfi Merxha, Heset Cakolli, Ali Lajçi dhe Elheme Hetemi, si dhe nga stafit mbështetës i Komisionit, Bajram Badivuku.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për anëtarët e Komisionit i mbulon nikoqiri, ndërsa të gjitha shpenzimet për koordinatorin e Komisionit, si dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094

- 3.13 Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve Hydajet Hyseni dhe Naser Rugova, për vizitë zyrtare në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. U lejohet udhëtimi deputetëve Hydajet Hyseni dhe Naser Rugova për të marrë pjesë në Konferencën rajonale, me temën: "Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit", e cila mbahet në Turqi, prej 8-11 qershor 2010.

2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit i mbulon organizatori-UNDP, ndërsa shpenzimet udhëtimit dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094

3.14 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, për vizitë zyrtare në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. U lejohet udhëtimi në Turqi, prej 9- 13 qershor 2010, anëtarëve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport, në këtë përbërje: Arsim Rexhepi, Drita Kadriu, Enis Kervani, Adem Hajdaraj, Heset Cakolli, Donika Kadaj dhe Dragan Dimiq, si dhe nga administrata e Kuvendit: Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu dhe Gylten Novobrdaliu.

2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për anëtarët e Komisionit i mbulon nikoqiri, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.15 Kryesia u njoftua për vizitat e realizuara të Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi në Kuvendin e Shqipërisë dhe të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Parlamentin e Finlandës.

Të ndryshme:

Ibrahim Gashi ngriti çështjen e dokumenteve që po publikohen në faqen e internetit të Kuvendit, pa u redaktuar dhe lekturuar.

Lidhur me këtë u konstatua se asnjë dokument i Kuvendit të mos publikohet në faqe të internetit pa u nënshkruar dhe autorizuar nga personat përgjegjës të Kuvendit.

Eqrem Kryeziu e njoftoi Kryesinë për takimin që kishte zhvilluar me një delegacion të Parlamentit të Zvicrës, si dhe për bisedimet që kishte pasur me ta.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale